



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE  
SENATI AKADEMIK**

**VENDIM**

Nr. 02 datë 18.02.2021

**PËR**

**NGRITJEN E LABORATORIT TË KONSERVIMIT DHE ARKEOMETRISË**

Në mbledhjen e datës 18.02.2021, Senati Akademik i Akademisë së Studimeve Albanologjike, nisur nga propozimi me anë të shkresës Nr. 64 Prot., datë 12.02.2021 i drejtuesve të Institutit të Arkeologjisë dhe Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, si dhe nga nevoja e domosdoshmëria e restaurimit të arkivave materiale të ASA-së, diskutoi për ngritjen e një laboratorit restaurimi. Laboratori i Konservimit dhe Arkeometrisë ka funksionuar që nga viti 1972, me statusin e një sektori shkencor. Mbas viteve 90 ky laborator filloi të shkojë drejt degradimit. Institucionet shtetërore nuk treguan interes për të, nuk dhanë financime për blerje aparaturash bashkëkohore dhe as u kujdesën për të vënë në dispozicion një ambient ku do të duhej të vijonte puna normalisht, gjë e cila solli amortizimin dhe daljen jashtë funksionit të tij. Natyrisht një laborator i kësaj natyre ndihmon shumë në kryerjen e analizave të ndryshme dhe restaurimin e objekteve me rëndësi të veçantë. Ndoshtur në këtë situatë emergjente ku procesi i trajtimit të objekteve arkeologjike dhe etnografike nuk funksionon, rrezikohet seriozisht konservimi dhe ruajtja e objekteve me karakter unik që janë në fondet arkeologjike dhe etnografike. Duke parë nevojën e domosdoshme për ringritjen e laboratorit, Instituti i Arkeologjisë konkurroi në projektet e Bashkimit Evropian për të përthithur fonde për ngritjen e një laboratorit modern në nivel bashkëkohor dhe fitoi projektin REACH, me një financim prej 96.820 eurosh, prej të cilave 40.000 euro janë parashikuar për blerjen e pajisjeve të laboratorit. Për të gjitha sa më sipër kërkohet dhe shtimi i dy vendeve pune me emërtesë specialist, që do të jenë pjesë e këtij laboratorit, të cilët do të trajnohen si pjesë e projektit. Senati Akademik pasi u njoh me këto fakte dhe rëndësinë që paraqet laboratorit për mirëmbajtjen e arkivave materiale me vlera të veçanta:

**VENDOSI:**

Miratimin e ngritjes së Laboratorit të Konservimit dhe Arkeometrisë, si njësi kërkimore shkencore në strukturën e Akademisë së Studimeve Albanologjike, që do të shërbejë në mbrojtjen dhe përpunimin e objekteve të arkivave materiale të instituteve të ASA-së.

Në strukturën e tij do të ketë 2(dy) punonjës me emërtesë, specialist klasa IV-a.

Struktura e ASA-së shtohet me 2(dy) punonjës, dhe shkon në total, 125 punonjës.

Ngarkohet administratori Z. Endrit Pollo për të përgatitur materialin e detajuar mbi koston financiare, që rrjedh nga marrja e këtij vendimi dhe për të paraqitur për miratim në Bordin e Administrimit shtesën për 2(dy) vende pune në strukturën e ASA-së.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**AKADEMIK PROF. DR. MARENGLIEN VERLI**

